



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SHOQËRIA RAJONALE
UJËSJETLLËS KANALIZIME ELBASAN sha**

Elbasan, më 08.08.2025

PROCES-VERBAL

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje matësa uji për nevojat e shoqërisë”

Procedurë e hapur e thjeshtuar, mallra

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 38421100-3

VLERA E FONDIT LIMIT: 3,990,600(tre million e nentëqind e nentëdhjetë mijë e gjashtëqind)
Lekë, **pa TVSH.**

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Shoqëria **UK Rajoni Elbasan**, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1. Kapaciteti ligjor/profesional i operatorëve ekonomikë:

a) të ketë të shënuar në license artikujt objekt prokurimi

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 (tre) vitet e fundit financiare nga data e zhvillimit të tenderit, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jete jo më e vogël se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe neni 43 dhe nenin 55, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë pasqyrat financiare vjetore (bilancet) gjatë 3(tre) viteve të fundit nga data e zhvillimit të tenderit të certifikuar nga organet tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr.10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me akt-ekspertizën e ekspertit kontabël të autorizuar. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht në nenin 29, pika 1 të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat" i ndryshuar si dhe kërkesave të Ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate,

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdoshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standardi të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast për zgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë autorizim/marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje autorizim distributori zyrtar, nga operatori ekonomik ofertues duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, fax, e-mail, website, kjo e nevojshme për AK në rast verifikimi nga ana e tij.

Përshkrimi i Produkteve

1	Matesa uji + buketona Ø -1/2"
2	Matesa uji + buketona Ø-1"

3	Matesa uji + buketona Ø-11/4"
4	Matesa uji + buketona Ø-11/2"
5	Matesa uji + buketona Ø-2"
6	Matesa uji DN 80mm- me fllanxhe
7	Matesa uji DN 100mm- me fllanxhe
8	Matesa uji DN 125mm- me fllanxhe
9	Matesa uji DN 150mm- me fllanxhe
10	Matesa uji DN 200mm- me fllanxhe
11	Vula me logo UKRE

Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën sipas pikës 2.3.2, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen. Në rast se katalogët janë në gjuhë të huaj, atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Shënim: Fragmentet e katalogut/ve duhet të tregojnë lehtësisht dhe qartë që janë pjesë katalogu, si dhe cilit katalog dhe cilit prodhues i përkasin.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot. 3341/1.Njësia e Prokurimit gjykon se kriteri i përcaktuar nga autoriteti kontraktor mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjesëtim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses.Në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria me specifikimet teknike dhe standardet e kërkuara, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë katalogun/ët ose fragmente të katalogut/ëve e prodhuesit/ve për listën sipas pikës 2.3.2, në të cilët të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen. Në rast se katalogët janë në gjuhë të huaj, atëherë duhet të paraqiten të përkthyer në gjuhën shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, germa b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” *Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë. Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të*

verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

-Operatori ekonomik duhet të paraqesë pranë AK-së në datën dhe orën e hapjes së ofertave nga një mostër fizike për artikujt sipas listës së mëposhtme. Mosparaqitja e mostrave është kusht për s'kualifikim.

Nr.	Emërtimi i Artikujve		
		Njesia	Sasia
1	Matesa uji + buketona Ø -1/2"	set	1
2	Matesa uji + buketona Ø-1"	set	1
3	Matesa uji + buketona Ø-1 1/4"	set	1
4	Matesa uji + buketona Ø-1 1/2"	set	1
5	Matesa uji + buketona Ø-2"	set	1
6	Matesa uji DN 80mm- me fllanxhe	set	1
7	Matesa uji DN 200mm- me fllanxhe	set	1
8	Vula me logo UKRE	cope	1
9	Tel bakri ø 0.05 mm	Kg	1

2.3.3 Operatori ekonomik ofertues duhet të jetë i Certifikuar sipas standardeve ISO të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit të cilat janë të akredituara nga DPA ose nga organizmat ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, konkretisht:

- a) Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (**ose ekuivalente**) (e vlefshme). (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO sipas zërave që do të marrë përsipër sipas akt-marrëveshjes).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot. 3341/1. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë pjesëmarrës të dëshmojnë i plotësojnë kërkesat e cilësisë për mallrat që do të furnizohen, e rrjedhimisht është e drejtë e AK t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga organe të pavarura të njohura nga Sistemet e Standardizimit Kombëtar ose Ndërkombëtar.

ISO 9001 parashikon një tërësi rregullash që garantojnë një bazë rreziku parandalues ndaj cilësisë e cila mbulon një gamë të gjerë të çështjeve ku përfshihen: angazhimi i lartë i menaxhimit për cilësi nga furnizuesi, fokusin e klientit, përshtatshmërinë e burimeve të tij, kompetencën/profesionalizmin e punonjësve, procesi i menaxhimit (për prodhim, ofrimit të shërbimeve dhe proceset mbështetëse e administrative), planifikimin e cilësisë, dizenjimi i produkteve dhe shërbimet që ofron, garantimin e një procesi cilësor të furnizimit, sigurimin e

konformitetit për mallrat dhe shërbimet, proceset e tij për të zgjidhur ankesat e konsumatorëve, veprime korrigjuese, dhe një kërkesë për të nxitur përmirësimin. Kjo kërkesë, dëshmon se mbajtësi i saj garanton standardet ndërkombëtare të menaxhimit të cilësisë së ushtrimit të aktivitetit tregtar të tij.

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik një deklaratë me anë të së cilës duhet të deklarojë se në momentin e dorëzimit të mallit pranë AK, do të paraqesë certifikatën origjinale të origjinës së mallrave ose fotokopje të noterizuar të saj.

2.3.5. Ofertuesi duhet të dorëzojë dokumentin e titulluar “Ofertë Teknike” i paraqitur nga Autoriteti Kontraktor në formën e një table, kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë artikujt e Listës.

Dokumenti “Ofertë teknike” duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Emërtimi i produkteve duhet të bëhet sipas listës ose preventivit të paraqitur nga AK.

Nr.	Emërtimi i produkteve	Emërtimi kompanisë prodhuese, adresa, web-siti	Emërtimi i katalogut	Referenca në katalogë/	Shënimet
				KOD i produktit ose nr. Faqes në katalog	

-Emri, Adresa dhe web-site i kompanisë prodhuese ose distributor i autorizuar, me produktet e të cilëve Operatori Ekonomik do të paraqitet në ofertim.

-Referenca në katalogët, kodi i produktit të plotësohet (në rast se mungon kodi i produktit të plotësohet nr. i faqes)duke treguar kodin ose numrin e faqes së katalogut në katalogun përkatës ku AK mund të gjejë specifikimet teknike të ofertuesit të cilat duhet të përputhen me specifikimet e AK.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot. 3341/1, si dhe njoftimit të APP-së nr. prot. 7459/4, datë 25.05.2021.

Vendosja e kriterit të mësipërm mbi paraqitjen e certifikatës origjinale të origjinës së mallrave në momentin e dorëzimit të mallrave ka për qëllim për të vërtetuar origjinën e mallit të ofertuar, për të garantuar se produktet do jenë të njëjta, të të njëjtit prodhues që do të paraqesë në sistemin elektronik si dhe për të bërë të mundur gjurmimin e prodhuesit, emri dhe adresa e të cilit duhet të jetë e njëjta me emrin dhe adresën e stampuar në trupin e produktit, për të shmangur falsifikimin e produkteve.

2.3.6. Për produktet e kërkuara në procedurën objekt prokurimit, operatori ekonomik duhet të vetedeklarojë që furnizuesi është komfort standarteve për artikujt objekt i këtij prokurimi. AK rezervon të drejtën për verifikimin e vetedeklarimit në procesin e vlerësimit të dokumentacionit si dhe në rastin kur OE shpallet fitues AK do të kërkojë paraqitjen e certifikatave aprovimi MID (ose ekuivalente) të prodhuesit. Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". MID- është certifikatë e bazuar në Direktivën e Instrumenteve të Matjes, e cila nënkupton Miratimin e tipit të matësit dhe Vlerësimin e Sistemit të Kontrollit të Cilësisë së Prodhimit. Pajisja me këtë certifikatë, nënkupton që prodhuesi e ka të aprovuar tipin e matësit, dhe gjithashtu ka të vlerësuar sigurinë e cilësisë nga një trupë notifikuese e miratuar Evropiane, në mënyrë periodike, dhe mund të vendosi në produkt MID, për të shmangur produktet me MID fals, apo të modifikuar).

2.3.7. Operatori ekonomik për artikujt : matesuji $\frac{1}{2}$ dhe mates uji $\frac{3}{4}$ objekt i këtij prokurimi duhet të paraqesë certifikatë higjene që i perkasin ketyre artikujve të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar.

Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Operatori ekonomik për produktet e kërkuara objekt prokurimi, të paraqesë Certifikatë Konformiteti OIML, sipas R49/2006, ose ekuivalente sipas rekomandimeve të Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore.

Në rast se certifikata është në gjuhë të huaj, operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatën përkatëse (të përkthyer dhe të noterizuar).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo Certifikatë higjene, nënkupton që produktet e ofertuara janë të materialeve të tilla, që mund të përdoren për kalimin e ujit të pijshëm. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik". Kjo certifikatë tregon përputhshmërinë e mallrave të ofertuar me rekomandimet e Organizatës Ndërkombëtare të Metrologjisë Ligjore, konkretisht për matësit e ujit të pijshëm.

2.3.8. Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë se mallrat e ofertuar prej tij kanë një garanci 1 (një) vjeçare nga marrja në dorëzim e tyre.

Vendosja e këtij kriteri behet me qëllim krijimin e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, se mallrat objekt prokurimi me të cilët do të furnizohet ky i fundit kanë garanci minimumi 1 (një) vjeçare nga marrja në dorëzim e tyre.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për s'kualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

*Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar**, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.*

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Argumentimi i specifikimeve teknike është bërë në specifikimet teknike të pasqyruara në shtojcën 6 të DST-së objekt prokurimi.

Njësia e Prokurimit